



#01024

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Instituti i Statistikave (INSTAT), kërkon të punësojë punonjës me kontratë pune në pozicionet:

"Specialist Prokurimi" në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave

TITULLI I SHPALLJES "SPECIALIST PROKURIMI"

Termet e referencës:

Detyrat Kryesore të Specialistit të prokurimeve:

- Përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti) në përputhje me legjislacionin e përcaktuar;
- Hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;
- Përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre;
- Hartimin dhe dërgimin e ftesave për pjesëmarrje kandidatëve të ftuar në një procedurë prokurimi;
- Administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti, sipas formave të përcaktuara nga Rregullat e PRAG 2018;
- Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor;
- Përgatit projekt kontratat në përfundim të procedurave të prokurimit dhe kujdeset për nënshkrimin e tyre;
- Ndjek dhe monitoron zbatimin e kontratave që i janë ngarkuar;

Kriteret e përzgjedhjes:

- Te zoteroje diplome univeristare në shkencat juridike.
- Preferohet të ketë eksperiencë në procedurat e prokurimeve.

Informacione të tjera: Fusha e Njohurive:

- Njohuri të mira të Rregullave të PRAG 2018, për zhvillimin e procedurave të prokurimit.
- Njohuri të mira të legjislacionit shqiptar në fuqi për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.
- Aftësi të mira komunikimi verbal dhe me shkrim, aftësi të mira ndërpersonale dhe aftësinë për të punuar në mënyrë të pavarur apo si pjesë e një grupi.
- Të ketë njohuri mbi gjuhën angleze.

Afati i aplikimit: 9/30/2021

Aplikimi realizohet nëpërmjet faqes së Institutit të Statistikave në seksionin e vëndeve vakante për pozicionet me kontrata të përkohëshme.

Ju duhet të hyni / rregjistroheni më parë në sistem për të aplikuar për këtë pozicion pune
(<http://rekrutime.instat.gov.al/aplikant>)

